



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. 07-111/01-0035362/26

Datë: 19.06.2026

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52, Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore në Kosovë, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

KONKURS

(Për regjistrimin e fëmijëve në Institucionet Parashkollore Publike të Komunës së Mitrovicës së Jugut)

Nr.	Grup Moshat	Vendi	Vende të lira
1	9 muaj deri në 1 vit	Institucioni Parashkollor - Gëzimi Ynë	10
2	1 vit deri në dy vjet	Institucioni Parashkollor - Gëzimi Ynë	9
3.	9 muaj deri në 1 vit	Institucioni Parashkollor – Dritë Dielli	9



I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet:

- Formulari i aplikimit (merret në Institucionet Parashkollore "Gëzimi Ynë" dhe "Dritë Dielli");
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Çertifikata e vendbanimit;
- Faturat e shërbimeve komunale, jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë;
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Dokumente të tjera origjinale ose të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse të specifikuar në Vendimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit nr. protokoli: 07-610/01-0035361/26 të datës: 19.06.2026.

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në Institucionet Parashkollore

- Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligjit nr.02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.04/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në Institucion Parashkollor Publik të Drejtorisë Komunale të Mitrovicës së Jugut me nr.protokoli:07-610/01-0035361/26 te datës: 19.06.2026.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më 22.06.2026 deri më 30.06.2026;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Institucionet Parashkollore "Gëzimi Ynë" dhe "Dritë Dielli", **çdo ditë pune prej orës 09:00 deri 15:00;**
- Shpallja e rezultateve bëhet më datën 03.07.2026 në Institucionet Parashkollore "Gëzimi Ynë" dhe "Dritë Dielli";
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në Institucionet Parashkollore "Gëzimi Ynë" dhe "Dritë Dielli" në afat prej tre (3) ditësh pas datës së publikimit të rezultateve;

Vërejtje: Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuara në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

